



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 235

Tiranë – E hënë, 5 dhjetor 2016

PËRMBAJTJA

Faqe

Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 70, datë 24.11.2016	Me objekt: Shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të pikave 1/1 dhe 2/1, të nenit 62, si dhe të germës “e/3”, të pikës 1, të nenit 66, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, me ligjin nr. 178/2014. - Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën i vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1037, datë 16.12.2015, “Për procedurat e vlerësimit të nëpunësve civilë për përfitimin dhe përditësimin e njohurive shtesë”. - Pezullimin e zbatimit të pikave 1/1 dhe 2/1, të nenit 62, si dhe i germës “e/3”, të pikës 1, të nenit 66, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar me ligjin nr. 178/2014. - Pezullimin e zbatimit të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1037, datë 16.12.2015, “Për procedurat e vlerësimit të nëpunësve civil për përfitimin dhe përditësimin e njohurive shtesë”.....	24265
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 71, datë 30.11.2016	Me objekt: Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr. 00-2015-3057, datë 9.12.2015, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.....	24273
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 126, datë 23.11.2016	Për miratimin e disa ndryshimeve në rregulloren “Për funksionimin e sistemit qendror të regjistrimit dhe shlyerjes së titujve (AFISaR)”.....	24281
Njoftim i Ministrisë së Punëve të Jashtme nr. 14148, datë 24.11.2016	Mbi hyrjen në fuqi të marrëveshjeve ndërkombëtare.....	24285



VENDIM
Nr. 70, datë 24.11.2016

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja kryetar i Gjykatës Kushtetuese

Vladimir Kristo anëtar i “ “

Sokol Berberi anëtar i “ “

Altina Xhoxhaj anëtare e “ “

Fatmir Hoxha anëtar i “ “

Gani Dizdari anëtar i “ “

Besnik Imeraj anëtar i “ “

Fatos Lulo anëtar i “ “

Vitore Tusha anëtare e “ “

me sekretare Edmira Pacani, në datën 7.7.2016, mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 36 Akti, që i përket:

KËRKUES: Avokati i Popullit

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Këshilli i Ministrave

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të pikave 1/1 dhe 2/1, të nenit 62, si dhe të germës “e/3”, të pikës 1, të nenit 66, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, me ligjin nr. 178/2014.

Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1037, datë 16.12.2015, “Për procedurat e vlerësimit të nëpunësve civilë për përfitimin dhe përditësimin e njohurive shtesë”.

Pezullimi i zbatimit të pikave 1/1 dhe 2/1, të nenit 62, si dhe i germës “e/3”, të pikës 1, të nenit 66 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar me ligjin nr. 178/2014.

Pezullimi i zbatimit të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1037, datë 16.12.2015, “Për procedurat e vlerësimit të nëpunësve civil për përfitimin dhe përditësimin e njohurive shtesë”.

BAZA LIGJORE: Nenet 4/1, 5, 11, 15, 17, 18/1, 41, 42/2, 60/1, 116, 118, 122, 124, 131/a dhe 134/dh të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 6/1 dhe 13, të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut; neni 1 i Protokollit nr. 1, të KEDNJ-së; neni 49, i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të

Republikës së Shqipërisë”; neni 24/c, i ligjit nr. 8454, datë 4.2.199, “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Vitore Tusha, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuarit, që është shprehur për pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjekteve të interesuara, Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave, që kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kuvendi i Shqipërisë në vitin 2014, me propozim të Këshillit të Ministrave, ka miratuar ligjin nr. 178/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 152/2013, datë 30.5.2013, “Për nëpunësin civil” (në vijim “ligji nr. 178/2014”). Ky ligj, midis të tjerash, ka sjellë ndryshime dhe shtesa në nenet 62 dhe 66, të ligjit të mëparshëm, të cilat rregullonin respektivisht çështjen e vlerësimit të rezultateve në punë, si dhe lirim të nëpunësit nga shërbimi civil.

2. Konkretisht, neni 22 i ligjit nr. 178/2014, i cili ka ndryshuar nenin 62 të ligjit nr. 152/2013, ka shtuar, midis të tjerash, pikat 1/1 dhe 2/1 si vijon: “1. Vlerësimi i rezultateve në punë është procesi i verifikimit të realizimit të përgjithshëm të objektivave të përcaktuar në fillim të periudhës së vlerësimit, si dhe i aftësive apo dobësive të nëpunësit në kryerjen e detyrave, që realizohet çdo 6 muaj. 2. Pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje: “1/1 Përveç vlerësimit, sipas pikës 1 të këtij neni, nëpunësit vlerësohen periodikisht, sipas përcaktimeve me vendim të Këshillit të Ministrave, edhe për përfitimin dhe përditësimin e njohurive shtesë të nevojshme për realizimin e funksioneve të tyre, në përputhje me kategorinë/grupin e administrimit të përgjithshëm/posaçëm ku bëjnë pjesë. Në çdo rast, procesi i vlerësimit të kryer sipas kësaj pike duhet të garantojë anonimatit e nëpunësit civil të vlerësuar.” 3. Pas pikës 2 shtohet pika 2/1 me këtë përmbajtje: “2/1 Në rast të vlerësimit jokënaqshëm në procedurën e vlerësimit të njohurive shtesë, sipas pikës 1/1 të këtij neni, nëpunësi i nënshtrohet një trajnimit të detyrueshëm dhe rivlerësimi 3-mujor.”

3. Neni 24 ka ndryshuar nenin 66, ku përcaktohetin rastet e lirimit nga shërbimi civil,



duke shtuar, midis të tjerash, edhe pikën “e/3” me këtë përmbajtje: “e/3) në rast se vlerësohet përsëri “jokënaqshëm” në përfundim të procedurës së rivlerësimit sipas pikës 2/1 të nenit 62.”

4. Këshilli i Ministrave, në zbatim të parashikimeve të ligjit nr. 178/2014, ka miratuar vendimin nr. 1037, datë 16.12.2015, “Për procedurat e vlerësimit të nëpunësve civilë, përfitimin dhe përditësimin e njohurive shtesë” (në vijim “VKM nr. 1037/2015”), efektet juridike të të cilit kanë filluar nga data 1.1.2016. VKM-ja përcakton rregulla të hollësishme lidhur me kategorizimin/grupimin e nëpunësve për efekt të zhvillimit të testimit paraprak dhe, kur është e nevojshme, të trajnimit çdo katër vjet; kompetencat e Departamentit të Administratës Publike (DAP-i) dhe Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASPA) në këtë proces; procedurat konkrete të zhvillimit të testimit apo të trajnimit, përfshi njoftimin e nëpunësve, ngritjen e komisioneve të vlerësimit paraprak, përzgjedhjen e ekspertëve, sistemin e vlerësimit etj.

II

5. **Kërkuesi, Avokati i Popullit** (në vijim “AP”), i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese në datën 5.4.2016 me kërkesë për shfuqizimin e pikave 1/1 dhe 2/1, të nenit 62, si dhe të germës “e/3”, të pikës 1, të nenit 66, të ligjit nr. 178/2014, si dhe të VKM-së nr. 1037/2015, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur si vijon:

5.1 *Për legjitimitimin*: në referim të nenit 134/dh të Kushtetutës, AP-ja legjitimohet *ratione personae*, pasi përfshihet në rrethin e subjekteve që mund të vënë në lëvizje gjykimin kushtetues abstrakt të normës, por sipas pikës 2 të këtij neni kjo e drejtë kufizohet vetëm në çështjet që lidhen me interesat e tij. Sipas nenit 60 të Kushtetutës, AP-ja mbron të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike. Në këtë kuptim, edhe interesi për të vënë në lëvizje gjykimin kushtetues lidhet me funksionin kushtetues që AP-ja ushtron kur si rrjedhojë e zbatimit të ligjit, aktit normativ nënligjor cenohen të drejtat e liritë themelore të individëve nga organet e administratës publike. Po ashtu, AP-ja

legjitimohet *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur brenda afatit 3-vjeçar të përcaktuar nga neni 50, i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, si dhe *ratione materiae*, pasi normat objekt kundërshtimi cenojnë sigurinë juridike dhe të drejtën për një proces të rregullt ligjor të shtetasve, nëpunës civilë, të cilët i janë drejtuar AP-së me ankesa konkrete.

5.2 *Është cenuar parimi i sigurisë juridike*, në disa drejtime:

5.2.1 Ligji nr. 178/2014 nuk parashikon shprehimisht në përkufizimet e dhëna në nenin 4 se çfarë kuptohet me termin “njohuri shtesë të nevojshme për realizimin e funksioneve të nëpunësve civilë”. Kjo paqartësi lë hapësira për subjektivizëm, duke pasur parasysh shumëllojshmërinë dhe veçantinë e posteve në administratën shtetërore dhe nuk garanton përmbushjen e objektivit të ligjit, që lidhet me krijimin e shërbimit civil të qëndrueshëm, profesional, të bazuar në merita, integritet moral dhe paanësi politike.

5.2.2 Është e paqartë gjithashtu nëse procesi i përfitimit dhe përditësimit të njohurive shtesë ka të bëjë me formimin profesional, apo është një proces tjetër i pavarur nga i pari, nisur nga rregullimi i pikës 3, të nenit 8, të ligjit të kundërshtuar ku përcaktohet se “*formimi profesional përfshin programin e formimit të thelluar të kandidatëve për kategorinë e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues... dhe programin e formimit të vazhdueshëm të nëpunësve civilë, si dhe të çdo individi tjetër jashtë këtij shërbimi nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike*”.

5.2.3 Ndryshimet ligjore krijojnë dy sisteme paralele vlerësimi në punë, të cilat janë kontradiktore dhe përjashtuese të njëra-tjetrës, për faktin se sistemi i verifikimit të përgjithshëm të objektivave të përcaktuar në fillim të periudhës së vlerësimit përfshin në vetvete edhe sistemin që lidhet me verifikimin e procesit të përfitimit dhe përditësimit të njohurive shtesë të nevojshme për nëpunësit civilë. Ky dyzim, krejtësisht i panevojshëm dhe përkeqësues në drejtim të së drejtës së fituar, është edhe më i dukshëm nëse i referohemi VKM-së nr. 1037/2015, ku parashikohet se “*testimi paraprak duhet të përfshijë të gjitha ndryshimet dhe të rejat që i përkasin fushës*



përkatëse sipas kategorisë/grupimit që i përket nëpunësi civil. Ndryshimet dhe të rejat që do të jenë pjesë e testimit përcaktoben nga DAP-i në bashkëpunim me institucionet e administratës shtetërore dhe të pavarura, në përputhje me profilin përkatës.”.

5.2.4 Rezultatet e vlerësimit sipas të dyja sistemeve janë akte administrative, të cilat në rast të vlerësimit “jokënaqshëm” përbëjnë shkak për lirimin nga shërbimi civil. Në këtë kuptim, është e paqartë se cili vlerësim do të sjellë efekte juridike nëse brenda të njëjtit vit nëpunësi civil vlerësohet “shumë mirë” në vlerësimin e përgjithshëm dhe “jokënaqshëm” në vlerësimin e njohurive shtesë.

5.2.5 Po ashtu, nuk kuptohet vlera e anonimatit të nëpunësit civil në procesin e testimit periodik, dhe akoma më pak se cilit sistem vlerësimi apo kohëzimi të njohurive shtesë profesionale i referohet periodiciteti i parashikuar në testimin e detyrueshëm, i parashikuar për t’u zhvilluar sipas VKM-së objekt kundërshtimi një herë në 4 vjet apo deri në 6 vjet. Ky fakt rezulton i paqartë edhe nga relacioni shoqëruar i projektit të VKM-së.

5.3 Është *cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor* në drejtim të së drejtës për t’u ankuar, pasi VKM-ja nr. 1037/2015, nuk përcakton në asnjë dispozitë të drejtën e ankimit të nëpunësit civil ndaj rezultatit të testimit nga ana e Komisionit të Vlerësimit Paraprak, çka të lë të kuptosh se rezultati është i padiskutueshëm, i pakundërshtueshëm dhe merret i mirëqenë për të vazhduar procedurat e mëtejshme.

6. **Subjekti i interesuar, Kuvendi i Shqipërisë**, ka prapësuar me shkrim në mënyrë të përmbledhur si vijon:

6.1 *Për legjitimitimin*: kërkuesi nuk legjitimohet për vënien në lëvizje të juridiksionit kushtetues, pasi nuk provon lidhjen e drejtpërdrejtë ndërmjet pretendimeve të ngritura dhe funksioneve të parashikuara nga Kushtetuta. Edhe pse provohet fakti i paraqitjes së disa ankesave nga subjekte të ndryshme, është plotësisht e qartë se atyre nuk ju është cenuar ndonjë e drejtë ose liri themelore. Gjykimi kushtetues është një garanci shtesë për të vënë në vend të drejtën e cenuar nga aktet e administratës publike apo përmbajtja e ligjeve.

6.2 *Për pretendimin për cenimin e parimit të sigurisë juridike*: administrata publike i ushtron funksionet e saj në shërbim të publikut dhe në këtë vështrim veprimtaria e saj mbart në vetvete një interes

publik, që në çështjen konkrete konsiston në ngritjen profesionale të nëpunësve civilë, me qëllim realizimin me cilësi të detyrave dhe ofrimin e shërbimeve me cilësi ndaj qytetarëve. Ligji dhe aktet nënligjore parashikojnë një sërë garancish në këtë drejtim. Mungesa e përkufizimit të “njohurive shtesë të nevojshme për realizimin e funksioneve të nëpunësve civilë” nuk e bën dispozitën të paqartë, pasi çdo nëpunës civil ka funksionet e tij, të cilat varen nga institucioni ku punon dhe aftësitë e tij. Për shkak se evoluimi i njohurive nuk ecën me ritme të njëjta në të gjitha fushat dhe po ashtu nisur nga shumëllojshmëria e pozicioneve të punës dhe profilizimit të tyre, ligji nuk mund të japë një përkufizim shterues të konceptit të njohurive shtesë të nevojshme.

6.3 I pambështetur është edhe pretendimi i kërkuesit në lidhje me krijimin e sistemeve paralele të vlerësimit, pasi secili prej tyre ka objektin e vet, të ndryshëm e të pavarur nga tjetri, por edhe strukturat kompetente për kryerjen e secilit vlerësim janë të ndryshme. Vlerësimi i njohurive shtesë është një filtër i ri, i cili i parashikuar si domosdoshmëri për rritjen e performancës së nëpunësit civil, është rregulluar me ligj e akt nënligjor. Ky parashikim është i kushtëzuar edhe nga ndryshimi i vazhdueshëm i legjislacionit shqiptar për shkak të përafrimit me atë të BE-së.

6.4 Pretendimi për përfshirjen e eprorit jo vetëm në vlerësimin periodik 6-mujor, por edhe në atë të përcaktimit të njohurive shtesë, është i pambështetur së pari, pasi vlerësimi periodik nuk përfshin njohuritë shtesë dhe së dyti, sepse VKM-ja nr. 1037/2015, që trajton në mënyrë të detajuar këtë aspekt, nuk përmend në asnjë rast eprorin e nëpunësit civil, por institucionin si tërësi.

6.5 Për sa i përket pretendimit për përjashtimin nga vlerësimi për verifikimin e përfitimit të njohurive shtesë të nëpunësve civilë që mbajnë grada shkencore, ai është në kundërshtim me nenin 18 të Kushtetutës, pasi vendos në kushte të pabarabarta një kategori nëpunësish civilë ndaj një kategorie tjetër, duke i diferencuar ata pa pasur një përligjje objektive dhe të arsyeshme.

7. **Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave**, ka prapësuar me shkrim si vijon:

7.1 *Për legjitimitimin*: kërkuesi nuk ka argumentuar mjaftueshëm kriterin *ratione materiae*. Ndonëse në kërkesë argumentohet se disa individë janë ankuar pranë AP-së në lidhje me pasigurinë juridike që u



krijohet nga dispozitat e reja ligjore, ato nuk janë vënë në zbatim, pasi ende nuk është zhvilluar ndonjë procedurë e vlerësimit të përfitimit dhe përditësimit të njohurive shtesë nga nëpunësit civilë. Përderisa normat objekt kundërshtimi nuk kanë gjetur zbatim dhe për sa kohë AP-ja është subjekt i kushtëzuar, ai në rastin konkret nuk legjitimohet për vënien në lëvizje të juridiksionit kushtetues.

7.2 *Për kërkesën e pezullimit të zbatimit të neneve të kundërshtuara të ligjit dhe të VKM-së* në kërkesë mungojnë argumente në lidhje me kriteret kushtetuese që duhet të plotësohen për të pezulluar zbatimin e normës juridike, të tilla si dyshimi serioz mbi vlefshmërinë e normës, që kërkohet t'i nënshtrohet kontrollit kushtetues, urgjenca që ekziston dhe, si rrjedhojë, domosdoshmëria e evitimit të dëmit serioz dhe të pariparueshëm si pasojë e zbatimit të saj apo lidhja me interesin publik në rastin konkret. Për më tepër, bazuar edhe në kërkesat e nenit 45, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” normat e kundërshtuara nuk cenojnë ndonjë interes shtetëror, shoqëror apo individual.

7.3 Pretendimi për cenimin e parimit të sigurisë juridike është i pabazuar. Sipas pikës 1/1, të nenit 62, të ligjit nr. 152/2013, vlerësimi i përfitimit të përditësimit të njohurive është një vlerësim i pavarur. Edhe pse ligji nuk përkufizon konceptin “njohuri shtesë të nevojshme për realizimin e funksioneve”, siç pretendon kërkuesi, ky element nuk e bën normën të paqartë, pasi mund të zbatohet metoda e interpretimit gjuhësor për të zbuluar kuptimin e saj. Njohuritë janë gjithmonë në evoluim dhe nuk mund t'u jepet kuptim shterues, për më tepër duke marrë në konsideratë shumëllojshmërinë e pozicioneve të punës në administratën publike dhe profilizimin e tyre.

7.4 VKM-ja nr. 1037/2015, parashikon një sërë procedurash dhe garancish që rregullojnë mënyrën e përcaktimit të njohurive shtesë nëpërmjet DAP-it dhe institucioneve ku bëjnë pjesë nëpunësit civilë që do të vlerësohen (pika 2, e kreut III), si dhe mundësojnë marrjen e dijeni në kohë për ditën e testimit dhe fushat e njohurive (pikat 4 dhe 5, të kreut III), mënyrën e vlerësimit të tyre (kreu III), si dhe pasojat në varësi të rezultatit të testit (pikat 16–22, të kreut III). Ndërkohë, kreu IV parashikon rivlerësimin dhe rritimin e

nëpunësit të vlerësuar “jokënaqshëm” herën e parë. Nëse nëpunësi, pas trajnimit nga ASPA, rritimit dhe vlerësimit nga eprori, merr përsëri “jokënaqshëm”, ai detyrohet të largohet nga shërbimi civil.

7.5 Nevoja e ndryshimit të sistemit të vlerësimit të njohurive të nëpunësve civilë është kushtëzuar nga natyra formale dhe joreale e sistemit të mëparshëm, i vlerësuar si i tillë në mënyrë të vazhdueshme nga organizmat ndërkombëtarë. Për më tepër, ndryshimi i sistemit të vlerësimit shfaqej si domosdoshmëri dhe mbart në vetvete interes publik, i cili konsiston në ngritjen profesionale të nëpunësve civilë, me qëllim realizimin me sa më shumë efikasitet të detyrave dhe ofrimin e një shërbimi cilësor ndaj qytetarëve.

7.6 Vlerësimi direkt nga eprori nuk duhet ngatërruar me vlerësimin e njohurive shtesë. Në pari, procedura e vlerësimit të rezultateve në punë nuk përfshin trajnimet, ngritjen profesionale apo procesin e verifikimit dhe përditësimit të njohurive shtesë. Në dyti, VKM-ja nr. 1037/2015, përmend institucionin, çka duhet kuptuar se jo domosdoshmërisht përcaktimi i njohurive shtesë bëhet vetëm nga eprori i nëpunësit civil.

7.7 Pretendimi për mënyrën e hartimit të testeve dhe pjesëmarrjen e DAP-it në proces nuk është ngritur në nivel kushtetues, pasi kërkuesi nuk argumenton se cili parim apo e drejtë cenohet. Edhe argumenti i konfliktit të interesit është i pabazuar, pasi nëpunësi që merr pjesë në procedurë nuk është anëtar i Komisionit të Vlerësimit, në referim të nenit 30 e vijues, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”.

7.8 Për sa i përket kohëzimit të njohurive shtesë, sistemi i vlerësimit përcaktohet si nga ligji, ashtu dhe VKM-ja. Nisur nga periodiciteti i vlerësimit, një herë në katër vjet, është e kuptueshme se ai përfshin të gjitha njohuritë shtesë të periudhës për secilin grup që do të vlerësohet.

7.9 Edhe pretendimi për anonimatën e nëpunësit nuk është ngritur në nivel kushtetues nga kërkuesi. Gjithsesi, ruajtja e anonimatit gjatë periudhës së vlerësimit synon të garantojë objektivitetin në vlerësimin e nëpunësit dhe të mbrojë integritetin moral e të dhënat e tij personale sipas detyrimeve të nenit 35 e vijues të Kushtetutës e legjislativitetit përkatës.

7.10 I pabazuar është edhe pretendimi për cenimin e së drejtës për akses dhe ankim në gjykatë.



Kushtetuta në nenin 42/2 parashikon të drejtën për akses, kurse në nenin 43 të drejtën e ankimit në një gjykatë më të lartë, parashikime këto të cilat sipas nenit 4/3 janë drejtpërdrejt të zbatueshme. Mosparashikimi në aktet e kundërshtuara i së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës nuk do të thotë se nëpunësi civil nuk e gëzon atë. Bazuar në nenin 17 të Kushtetutës, mohimi i kësaj të drejte duhet të parashikohej shprehimisht, qëndrim i cili bazohet edhe në jurisprudencën e GJEDNJ-së në çështjen “*Vilho Eskelinen dhe të tjerë kundër Francës*”. E drejta e ankimit garantohet edhe nga neni 7/a i ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative”.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuarit

8. Gjykata e ka vlerësuar çështjen e legjitimitimit të kërkuarit (*locus standi*) si një nga aspektet kryesore që lidhen me inicimin e gjykimit kushtetues të normës (kontrolli abstrakt). Kushtetuta në nenin 134/1/dh parashikon si subjekt që mund ta vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese edhe Avokatin e Popullit. Megjithatë, kjo e drejtë është e kushtëzuar, dhe mund të ushtrohet vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij. Pra, vetëm nëse e përmbushin kushtin e kërkuar nga paragrafi 2 i nenit 134 të Kushtetutës për të argumentuar “interesin e tyre” në një “çështje të veçantë”, subjektet e renditura në shkronjat “dh”, “e”, “ë” dhe “p”, të nenit 134/1, legjitimohen *ratione materiae* për t'iu drejtuar Gjykatës në lidhje me kompetencën e saj për të vendosur në këtë rast mbi pajtueshmërinë e ligjit me Kushtetutën (*shih vendimet nr. 17, datë 25.7.2008; nr. 10, datë 29.2.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Avokati i Popullit, sipas nenit 60 të Kushtetutës, mbron të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike. Pra, interesi i tij për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese duhet të lidhet me funksionin kushtetues që ushtron kur si rrjedhojë e zbatimit të ligjit ose aktit normativ nënligjor, nga veprimet ose mosveprimet e administratës publike, janë cenuar të drejtat dhe liritë themelore të individëve apo kur shkelja e të drejtave, lirive dhe interesave të individit vjen si rezultat i vetë përmbajtjes së

këtyre ligjeve apo akteve, d.m.th. kur ato janë në kundërshtim me Kushtetutën. Këto shkelje duhet të evidentohen në procesin e veprimtarisë së Avokatit të Popullit gjatë shqyrtimit të ankesave, kërkesave dhe njoftimeve që i paraqiten atij. Në këtë rast ai ka të drejtë t'u rekomandojë organeve që kanë të drejtën ligjvënëse të bëjnë propozime për ndryshimin dhe përmirësimin e ligjeve apo të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese me kërkesë për shfuqizimin e akteve të tilla (*shih vendimet nr. 29, datë 31.5.2010; nr. 10, datë 29.2.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Gjykata ka theksuar se kompetenca e Avokatit të Popullit për t'iu drejtuar kësaj Gjykate konsiderohet si një garanci shtesë që i është dhënë në mënyrë indirekte individit për të vënë në vend të drejtën e cenuar nga aktet e administratës publike dhe se është në diskrecionin e tij të zgjedhë mjetet e nevojshme për mbrojtjen e individëve nëse një normë është *prima facie* antikushtetuese (*shih vendimet nr. 27, datë 26.5.2010; nr. 20, datë 4.4.2014; nr. 10, datë 29.2.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Interesi i Avokatit të Popullit për ta vënë atë në lëvizje, në kuptim të nenit 134/2 të Kushtetutës, shqyrtohet rast pas rasti. Në rastin konkret, Gjykata çmon se kërkuari ka interes në çështjen konkrete, pasi i plotëson kriteret e përcaktuara në standardet e mësipërme, për rrjedhojë legjitimohet të vërë në lëvizje gjykimin kushtetues, duke karakterizuar kështu ekzistencën e lidhjes së drejtpërdrejtë ndërmjet pretendimeve të ngritura përpara Gjykatës dhe funksioneve të tij të parashikuara nga Kushtetuta.

11. Referuar standardeve të mësipërme, Gjykata çmon se kërkuari legjitimohet *ratione personae* përderisa ai është në zbatim të funksioneve të tij të parashikuara nga Kushtetuta. Gjithashtu, ai legjitimohet *ratione temporis*, pasi referuar datës së hyrjes në fuqi të ndryshimeve ligjore objekt kërkesë, kërkuari është brenda afatit 3-vjeçar të parashikuar nga neni 50, i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

12. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, Gjykata rithekson se kompetenca e Avokatit të Popullit për t'iu drejtuar kësaj Gjykate konsiderohet si një garanci shtesë që i është



dhënë në mënyrë indirekte individit për të vënë në vend të drejtën e cenuar nga aktet e administratës publike dhe se është në diskrecionin e tij të zgjedhë mjetet e nevojshme për mbrojtjen e individëve nëse një normë është *prima facie* antikushtetuese (shih vendimet nr. 27, datë 26.5.2010; nr. 20, datë 4.4.2014 të Gjykatës Kushtetuese). Në rastin konkret, kërkuesi ka interes në çështjen konkrete, pasi i plotëson kriteret e përcaktuara në standardet e mësipërme, për rrjedhojë legjitimohet të vërë në lëvizje gjykimin kushtetues.

13. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se prapësimi i subjekteve të interesuara, Kuvendit të Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave, në lidhje me moslegjitimitimin e kërkuesit është i pabazuar, pasi ekziston lidhja e drejtpërdrejtë ndërmjet pretendimeve të ngritura përpara Gjykatës Kushtetuese dhe funksioneve të kërkuesit të parashikuara nga Kushtetuta.

B. Për kërkesën për pezullimin e zbatimit të ligjit dhe VKM-së objekt shqyrtimi

14. Gjykata vëren se kërkuesi në objektin e kërkesës ka kërkuar pezullimin e zbatimit të ligjit nr. 178/2014 dhe VKM-së nr. 1037/2015, megjithatë në kërkesë mungojnë argumente konkrete për të provuar pasojat që mund t'i vijnë interesave shtetërorë, shoqërorë dhe të individit. Duke iu referuar parashtrimeve që lidhen me themelin e çështjes, AP-ja evidenton si pasojat kryesore që vijnë nga zbatimi i ligjit dhe VKM-së cenimin e sigurisë juridike të nëpunësit civil dhe të së drejtës së tij për një proces të rregullt ligjor në aspektin e ankimit të rezultatit të vlerësimit të përfitimit të njohurive shtesë.

15. Mbledhja e Gjyqtarëve në datën 8.6.2016 mori paraprakisht në shqyrtim kërkesën për pezullimin e zbatimit të ligjit dhe duke i vlerësuar shkaqet e parashtruara nga kërkuesi në kuptim të nenit 45 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", arriti në përfundimin se ato nuk janë të përligjura për të argumentuar parandalimin e pasojave që mund t'u vijnë të drejtave dhe lirive themelore të individëve, si dhe funksionimit normal të shtetit të së drejtës. Për rrjedhojë, Mbledhja e Gjyqtarëve vendosi mospranimin e kërkesës për pezullimin e zbatimit të ligjit dhe VKM-së objekt kundërshtimi.

C. Për themelin e çështjes

C.1 Për pretendimin e cenimit të parimit të sigurisë juridike

16. Kërkuesi ka pretenduar se normat ligjore e nënligjore objekt kundërshtimi cenojnë parimin e sigurisë juridike, pasi krahas mungesës së përkufizimit të koncepteve të caktuara, siç është rasti i "njohurive shtesë të nevojshme", ato përmbajnë formulime ligjore të paqarta si në lidhje me vlerësimin mbizotërues, në rast të dy vlerësimeve të kundërta, ashtu edhe me anonimatit e nëpunësit që i nënshtrohet vlerësimit të njohurive shtesë.

17. Pretendimet e mësipërme janë prapësuar nga subjektet e interesuara, Kuvendi i Shqipërisë dhe Këshilli i Ministrave, me argumentin se njohuritë shtesë të nevojshme për realizimin e funksioneve janë koncepte në evoluim dhe s'mund të përkufizohen në mënyrë shteruese. Sipas tyre, VKM-ja nr. 1037/2015, parashikon një sërë procedurash dhe garancish që rregullojnë mënyrën e përcaktimit të njohurive shtesë nëpërmjet DAP-it dhe institucioneve ku bëjnë pjesë nëpunësit civilë që do të vlerësohen. Për më tepër, sipas subjekteve të interesuara, sistemet e vlerësimit janë të ndryshme e të pavarura nga njëra-tjetra.

18. Në lidhje me parimin e sigurisë juridike, Gjykata rithekson se si element i shtetit të së drejtës, ky parim ka si kërkesë të domosdoshme që ligji në tërësi apo dispozita të veçanta të tij, në përmbajtjen e tyre të jenë të qarta, të përcaktuara dhe të kuptueshme. Për të kuptuar dhe zbatuar drejt parimin e sigurisë juridike kërkohet, nga njëra anë, që ligji në një shoqëri të ofrojë siguri, qartësi dhe vazhdimësi, në mënyrë që individët t'i drejtojnë veprimet e tyre në mënyrë korrekte e në përputhje me të dhe, nga ana tjetër, që vetë ligji të mos qëndrojë statik nëse duhet t'i japë formë një koncepti. Një rregullim i pasaktë i normës ligjore, që i lë shteg zbatuesit t'i japë asaj kuptime të ndryshme dhe që sjell pasoja, nuk shkon në përputhje me qëllimin, stabilitetin, besueshmërinë dhe efektivitetin që synon vetë norma (shih vendimin nr. 43, datë 26.6.2015 të Gjykatës Kushtetuese). Gjykata rithekson vlerën që merr ky element i shtetit të së drejtës në sigurimin e drejtësisë në një shoqëri që ndryshon me shpejtësi dhe, për rrjedhojë, ndikimin pozitiv që ai ka në hartimin dhe miratimin e ligjeve të



reja apo ndryshimin e atyre ekzistuese për t'i përshtatur me dinamikën e këtyre ndryshimeve (shih vendimin nr. 1, datë 6.2.2013 të Gjykatës Kushtetuese).

19. Gjykata rithekson se në zbatim të funksionit të saj, ajo nuk mund të kontrollojë ose të orientojë paraprakisht vullnetin e ligjvënësit që të veprojë ose jo në një kohë ose mënyrë të caktuar. Në këtë vijë arsyetimi, nuk mund të përbëjë çështje të juridiksionit kushtetues vlerësimi i arsyeve që mund të kenë ndikuar te ligjvënësi për trajtim të posaçëm të një çështjeje të caktuar. Është brenda hapësirës vlerësuese të ligjvënësit mënyra e rregullimit të një çështjeje të caktuar, ndërsa është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të kontrollojë nëse rregullimi me ligj i kësaj çështjeje është bërë në përputhje me Kushtetutën dhe parimet themelore të saj (shih vendimet nr. 30, datë 1.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese).

20. Duke iu rikthyer çështjes konkrete, Gjykata vëren se nga viti 2013 e në vijim marrëdhëniet juridike midis shtetit dhe nëpunësit civil rregullohen nga një kuadër i ri ligjor, konkretisht nga ligji nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", qëllimi i të cilit është krijimi i një shërbimi civil të qëndrueshëm, profesional, të bazuar në meritë, transparencë, integritet moral, paanësi politike, shanse të barabarta dhe mosdiskriminim (nenet 1 dhe 5 të ligjit nr. 152/2013). Nëpunësi civil, në kuptim të këtij ligji, është personi i cili kryen funksionin për ushtrimin e autoritetit administrativ publik, në bazë të aftësisë dhe profesionalizmit, i cili merr pjesë në formulimin dhe zbatimin e politikave, monitorimin e zbatimit e rregullave dhe procedurave administrative, sigurimin e ekzekutimit të tyre dhe ofrimin e mbështetjes së përgjithshme administrative për zbatimin e tyre (neni 4 i ligjit nr. 152/2013).

21. Gjykata vëren se ligji nr. 152/2013, midis të tjerash, rregullon edhe vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësit civil, duke e përkufizuar atë si "procesin vjetor të verifikimit të realizimit të përgjithshëm të objektivave të përcaktuara në fillim të periudhës së vlerësimit, si dhe të aftësive apo dobësive të nëpunësit në kryerjen e detyrave" (neni 62). Po ashtu, Gjykata konstaton se sipas VKM-së nr. 109, datë 24.2.2014, "Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësit civil", ky proces përfshin "vlerësimin e

realizimit të objektivave, vlerësimin e sjelljes profesionale, gabimeve/saktësisë në punën e kryer, realizimit në kohë të punës, kolegialitetit të marrëdhënieve, gatishmërisë për punë në grup, shpeshëtisë së orëve të punës jashtë orarit, kërkesave për këshillim dhe trajnimin e ngritjes profesionale". Si ligji nr. 152/2013, ashtu dhe VKM-ja e mësipërme për vlerësimin e rezultateve në punë i referohen një sistemi me katër nivele të shkallëzuara: "a) shumë mirë (1); b) mirë (2); c) kënaqshëm (3); ç) jokënaqshëm (4)". Niveli "jokënaqshëm" tregon se nëpunësi nuk ka realizuar objektivat dhe nuk ka përmbushur pritshmëritë lidhur me qëndrimin dhe sjelljen profesionale.

22. Parashikimet e mësipërme ligjore e nënligjore kanë pësuar ndryshime e shtesa me ligjin nr. 178/2014 dhe VKM-në nr. 1037/2015, objekt kundërshtimi. Gjykata konstaton se në lidhje me sistemin e vlerësimit në punë (në vijim "sistemi i parë"), normat e reja ligjore kanë ndryshuar periodicitetin e vlerësimit, duke e parashikuar atë "çdo 6 muaj" në vend të "një viti" që ishte më parë (neni 22, pika 2/1). Për sa i përket synimit të këtij vlerësimi, ai mbetet i njëjtë me atë të përcaktuar fillimisht nga ligji nr. 152/2013 dhe është përmirësimi i aftësive profesionale të nëpunësit civil dhe i cilësisë së shërbimit.

23. Gjykata vëren se përveç vlerësimit të rezultateve në punë të nëpunësit, normat objekt kundërshtimi parashikojnë edhe vlerësimin e përfitimit dhe përditësimit të njohurive shtesë të nevojshme për realizimin e funksioneve me periodicitet çdo 4 ose 6 vjet, proces që duhet të garantojë anonimatën e nëpunësit (në vijim "sistemi i dytë") (neni 22/2 i ligjit). Procesi i përfitimit dhe përditësimit të njohurive shtesë synon aftësimin e nëpunësve civilë dhe pajisjen e tyre me njohuri shtesë të nevojshme, sipas funksioneve dhe fushës ku ata veprojnë, me qëllim ngritjen e cilësisë së shërbimeve dhe të punës në institucionet e administratës civile, pjesë e shërbimit civil (krenu I, pika 1/1 e VKM-së). Objektivat e procesit, janë: a) përcaktimi i përshtatshmërisë së nëpunësit me pozicionin e punës që ai mban; b) zbulimi i aftësive për zhvillimin profesional; c) përcaktimi i nevojave për trajnime shtesë (shih pikën 1/3 të VKM-së). Gjykata konstaton se për arritjen e këtyre objektivave VKM-ja parashikon një proces vlerësimi që konsiston në dy faza: i) testimi



paraprak dhe, kur është e nevojshme; ii) trajnimi i nëpunësve civilë për njohuritë e reja që prekin fushën e tyre (*pika 1/2 e VKM-së*).

24. Në lidhje me pasojat që sjell secili sistem vlerësimi, Gjykata vëren se, sipas sistemit të parë, nëse nëpunësi civil merr dy vlerësime “jokënaqshëm”, marrëdhënia në shërbimin civil përfundon automatikisht nëpërmjet lirimit të nëpunësit civil (*neni 24/2*). Gjykata konstaton se procedurat e lirimit nga shërbimi civil janë përcaktuar fillimisht me VKM-në nr. 171, datë 26.3.2014, “*Për transferimin e përbershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil*”, e më pas me VKM-në nr. 124, datë 17.2.2016, “*Për pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil*”, të cilat parashikojnë, midis të tjerash, edhe të drejtën e nëpunësit civil për t’u ankuar në rrugë administrative e gjyqësore.

25. Në lidhje me sistemin e dytë të vlerësimit, Gjykata vëren se nëse nëpunësi vlerësohet “jokënaqshëm”, ai i nënshtrohet trajnimit të detyrueshëm dhe rivlerësimit 3-mujor (*neni 22/3*). Nëse pas rivlerësimit rezultati që merr është përsëri “jokënaqshëm”, nëpunësi civil lirohet nga shërbimi civil (*neni 24/3, germa e/3*). Referuar VKM-së nr. 1037/2015, objekt kundërshtimi, Gjykata konstaton se nëse një nëpunës civil vlerësohet “jokënaqshëm”, ai/a jo konsiderohet jo i përshtatshëm për vendin e punës ku është caktuar, për rrjedhojë është i detyruar të ndjekë, *së pari*, trajnimin pranë ASPA-s për përfitimin dhe përditësimin e njohurive shtesë, *së dyti*, t’i nënshtrohet vlerësimit 3-mujor nga eprori direkt dhe, *së treti*, t’i nënshtrohet testimit nga Komisioni i Vlerësimit (KV). Nëse nëpunësi vlerësohet përsëri “jokënaqshëm”, ai konsiderohet se nuk e ka kaluar testimin pranë KV-së. Gjykata vëren se në përfundim të procedurave të mësipërme, bazuar në rezultatet e testimit të KV-së dhe të vlerësimit 3-mujor, eprori direkt vendos përshtatshmërinë ose papërshtatshmërinë e nëpunësit me vendin e punës. Nëse nëpunësi vlerësohet jo i përshtatshëm, atëherë njësia e burimeve njerëzore deklaron përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil.

26. Në vështrim të sa më sipër, Gjykata çmon se sistemet e vlerësimit të nëpunësve civilë janë të ndryshme si për sa i takon objektivitetin e synimit, ashtu edhe procedurave të realizimit të tyre. Këto

sisteme vlerësimi janë instrumente përmes të cilave synohet të mbështetet veprimtaria dinamike e administratës publike, si në aspektin funksional, ashtu dhe atë strukturor. Në këtë kuptim, Gjykata e vlerëson të pabazuar pretendimin e kërkuarit mbi natyrën kontradiktore dhe përjashtuese të sistemeve të vlerësimit.

27. Për sa i takon argumentin tjetër të kërkuarit se është e paqartë se cili vlerësim do të sjellë efekte juridike nëse brenda të njëjtit vit nëpunësi civil vlerësohet “shumë mirë” në vlerësimin e përgjithshëm dhe “jokënaqshëm” në vlerësimin e njohurive shtesë, Gjykata, bazuar edhe në përfundimin e arritur në lidhje me dallimin midis dy sistemeve të vlerësimit, çmon se ky pretendim i kërkuarit është i pabazuar. Duke ju referuar normave ligjore e nënligjore, niveli “shumë mirë” i vlerësimit tregon se nëpunësi ka realizuar shumë mirë të gjithë objektivat dhe ka treguar një sjellje të qëndrueshme profesionale të dalluar nga të tjerët në harkun kohor të 6 muajve, kurse niveli “jokënaqshëm” tregon se ai është i papërshtatshëm për vendin e punës, vlerësim i cili konstatohet pas 4 ose 6 vjetësh. Gjykata, duke prezumuar zhvillimin e procedurave të vlerësimit të aftësive personale e profesionale çdo 6 muaj, në përputhje me kriteret e përcaktuara nga ligji dhe jo formalisht, e vlerëson të pabazuar këtë hipotezë të kërkuarit.

28. Në përfundimin Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuarit për cenimin e parimit të sigurisë juridike, si rezultat i mungesës së përkufizimit të konceptit “njohuri shtesë të nevojshme” apo të formulimeve të paqarta ligjore, është i pabazuar.

C.2 Për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit dhe ankimit në gjykatë

29. Kërkuari pretendon se VKM-ja nr. 1037/2015, cenon të drejtën për ankim efektiv të garantuar nga neni 43 i Kushtetutës, duke argumentuar se normat nënligjore nuk parashikojnë ndonjë mjet ankimi në dispozicion të nëpunësve civilë për të kundërshtuar aktin e Komisionit të Vlerësimit.

30. Gjykata referuar jurisprudencës kushtetuese rithekson se pretendimet e ngritura në këtë kontekst ajo i vlerëson në lidhje me të drejtën për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës. E drejta për t’u drejtuar gjykatës është një nga aspektet e së drejtës për gjykim, e



sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës. Kjo e drejtë kushtetuese, ndër të tjera, ka për qëllim të garantojë shtetasit nga çdo veprim që u shkakton cenim të të drejtave të tyre, pa përjashtuar rastet kur cenimi vjen nga ndonjë akt i administratës shtetërore. Shteti i së drejtës presupozon që çdo ndërhyrje e autoriteteve ekzekutive në të drejtat e individit apo të personave juridikë, duhet të jetë objekt i një kontrolli efektiv nga një organ që ofron garantimin e pavarësisë dhe paanësisë gjatë procesit të shqyrtimit të procesit (*shih vendimin nr. 10, datë 4.4.2007 të Gjykatës Kushtetuese*). E drejta për t'iu drejtuar gjykatës nënkupton të drejtën që ka çdo individ për të ngritur padi në një gjykatë që ka juridiksion të plotë për të zgjidhur çështjen (*shih vendimin nr. 10, datë 11.5.2006; nr. 43, datë 6.10.2011; nr. 25, datë 28.4.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Gjykata rithekson se standardi kushtetues i parashikimit të së drejtës së ankimit ndaj akteve të pushtetit publik nuk kërkon detyrimisht që edhe akti nënligjor, që del në bazë dhe për zbatim të ligjit, të parashikojë sërish këtë të drejtë, e cila është njohur nga një akt me fuqi juridike më të lartë në hierarkinë e akteve normative (*shih vendimin nr. 17, datë 25.7.2008; nr. 25, datë 28.4.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). E drejta e ankimit të shtetasve ndaj çdo veprimi/akti të paligjshëm të administratës publike rrjedh direkt nga neni 43 i Kushtetutës. Për këtë arsye ajo prevalon ndaj të gjitha akteve që nuk pajtohen me të, parim që buron nga zbatueshmëria direkt e Kushtetutës, garantuar në nenin 4 të saj.

32. Gjykata, në vështrim të sa më sipër, vlerëson se përderisa në rastin konkret të drejtën e ankimit gjyqësor e parashikon ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative”, ky rregullim ligjor është i mjaftueshëm për nëpunësit civilë për të realizuar të drejtën e ankimit gjyqësor ndaj akteve administrative që nxjerr Komisioni i Vlerësimit, pavarësisht se VKM-ja objekt shqyrtimi nuk shprehet për të. Për rrjedhojë Gjykata vlerëson se edhe ky pretendim i kërkuarit është i pabazuar.

33. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuarit për cenimin e parimit të sigurisë juridike dhe të së drejtës për ankim efektiv janë të pabazuara dhe si të tilla nuk duhen pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/a/c dhe 134/1/f të Kushtetutës, si dhe të nenit 72 e në vijim të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.¹

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha, Fatos Lulo, Besnik Imeraj

VENDIM

Nr. 71, datë 30.11.2016

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 1.11.2016 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 61 Akti, që i përket:

KËRKUESE: Fatjona Koçibelli

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria e Përgjithshme

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimit nr. 00-2015-3057, datë 9.12.2015, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

¹ Gjyqtarët S. Berberi, A. Xhoxhaj dhe F. Hoxha votuan për rrëzimin e kërkesës me arsyetimin e moslegjitimit të Avokatit të Popullit.



BAZA LIGJORE: Nenet 33/1, 42/2, 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 27 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Vladimir Kristo, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuases, që është shprehur për pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr. 41-2013-4745 (427), datë 4.12.2013, ka vendosur të deklarojë fajtorë kërkuosen për kryerjen e veprës penale shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor, të parashikuar nga neni 290/1 i Kodit Penal (KP), dhe në bazë të kësaj dispozite e ka dënuar atë me 4 (katër) vjet burgim.

2. Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr. 63, datë 8.4.2014, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 427, datë 4.12.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, dhe në bazë të nenit 59 të Kodit Penal ka urdhëruar pezullimin e ekzekutimit për pjesën e mbetur të dënimit me kusht për tre vjet, duke mbajtur kërkuësja kontakt me Zyrën Vendore të Shërbimit të Provës Korçë.

3. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2015-3057, datë 9.12.2015, mbi rekursin e subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 63, datë 8.4.2014 të Gjykatës së Apelit Korçë me ndryshimin: moszbatimi i nenit 59 të KP-së, duke hequr pezullimin e ekzekutimit të dënimit.

II

4. **Kërkuësja** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata), duke pretenduar shfuqizimin e vendimit objekt kërkesë, pasi ai i ka cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor në këto drejtime:

4.1 Gjykata e Lartë ka cenuar parimin e paanshmërisë, pasi ka bërë një vlerësim të gabuar të rrethanave të çështjes dhe provave, si dhe ka shqyrtuar çështjen në momentin kur publikisht ishte i njohur diskutimi në Kuvendin e Shqipërisë i ligjit “Për dhënie amnistie”, sipas të cilit amnistoheshin të gjitha dënimet alternative të dhëna me vendim të formës së prerë para datës 30.11.2015, sikurse ishte rasti konkret.

4.2 Gjykata e Lartë ka cenuar standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, sepse nuk ka arsyetuar lidhur me moszbatimin e dënimit alternativ të parashikuar nga neni 59 i KP-së.

4.3 Gjykata e Lartë ka cenuar të drejtën për t’u dëgjuar dhe për t’u mbrojtur, pasi nuk ka njoftuar kërkuosen dhe mbrojtjen e saj për seancën gjyqësore, ndërsa mbrojtësi i caktuar kryesisht nuk ka pasur mundësi të bëjë një mbrojtje efektive.

5. **Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme**, ka prapësuar me shkrim, në mënyrë të përmbledhur, si më poshtë vijon:

5.1 Kërkuësja nuk e ngritur në nivel kushtetues pretendimin për njëanshmëri të Gjykatës së Lartë. Fakti se kjo e fundit ka vendosur moszbatimin e nenit 59 të KP-së, duke hequr pezullimin e ekzekutimit të dënimit, nuk përbën bazë të mjaftueshme për të arritur në përfundimin se është shkelur ky parim.

5.2 Vendimi i kundërshtuar nuk rezulton të jetë alogjik, të ketë kundërthënie, si dhe ka respektuar të gjitha elementet e përcaktuara nga jurisprudenca kushtetuese lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor.

5.3 Nuk është cenuar e drejta për t’u dëgjuar dhe për t’u mbrojtur, sepse Gjykata e Lartë i ka marrë masat e domosdoshme për garantimin e procesit të rregullt ligjor, duke njoftuar palët me anë të shpalljes së listës së gjykimeve para godinës, si dhe nëpërmjet faqes zyrtare në internet, duke i caktuar kërkuoses një mbrojtës kryesisht dhe duke mos lejuar zhvillimin e seancës në mungesë të një avokati.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuases

6. Kërkuësja legjitimohet *ratione personae* në lidhje me pretendimet e paraqitura në kërkesë, në kuptim të neneve 131/f dhe 134/1/i të



Kushtetutës, dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur në Gjykatën Kushtetuese brenda afatit të parashikuar nga neni 30 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

7. Gjithashtu, Gjykata vlerëson se kërkesja *prima facie* legjitimohet edhe *ratione materiae*, pasi pretendimet e saj hyjnë në juridiksionin kushtetues. Këto pretendime janë shqyrtuar në vijim në këndvështrim të standardeve që imponon procesi i rregullt ligjor në kuptimin kushtetues.

B. Për pretendimin për cenimin e së drejtës për t’u dëgjuar dhe për t’u mbrojtur në Gjykatën e Lartë.

8. Kërkesja pretendon se Gjykata e Lartë i ka cenuar të drejtën për t’u dëgjuar, pasi nuk e ka njoftuar atë dhe mbrojtjen e saj për seancën gjyqësore. Sipas kërkeses Gjykata e Lartë e ka shpallur datën e gjykimit të çështjes vetëm disa ditë përpara seancës gjyqësore, duke mos i dhënë mundësi asaj dhe mbrojtësit të saj të marrin dijeni për seancën, si dhe duke i caktuar një mbrojtës kryesisht. Ky i fundit nuk ka pasur mundësi të njihet në detaje me problemet juridike të çështjes, duke mos realizuar kështu një mbrojtje efektive të kërkeses.

9. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, ka prapësuar se nuk është cenuar e drejta për t’u dëgjuar dhe për t’u mbrojtur, sepse Gjykata e Lartë i ka marrë masat e domosdoshme për garantimin e procesit të rregullt ligjor, duke njoftuar palët me anë të shpalljes së listës së gjykimeve para godinës, si dhe nëpërmjet faqes zyrtare në internet, duke i caktuar kërkeses një mbrojtës kryesisht dhe duke mos lejuar zhvillimin e seancës në mungesë të një avokati.

10. Gjykata ka theksuar se veçanërisht në procesin penal, barazia e armëve, kontradiktoriteti dhe, lidhur ngushtë me këto, mbrojtja e të pandehurit, përbëjnë në vetvete elementet më të qenësishëm e thelbësore të procesit të rregullt ligjor në kuptimin kushtetues. Prandaj për respektimin e këtyre parimeve, gjykata duhet të përmbushë me rigorozitet një sërë detyrimesh, mes të cilave rëndësi të veçantë paraqet, sipas rastit, edhe njoftimi i të pandehurit apo mbrojtësit të tij ligjor për akuzën, ankimin, rekursin, ditën dhe vendin e gjykimit të çështjes,

etj. Synim kryesor është realizimi i një debati real ndërmjet akuzës dhe mbrojtjes, gjë që ndikon pozitivisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë në zbulimin e së vërtetës dhe dhënien e drejtësisë nga gjykata me objektivitet e paanësi. Këto kërkesa kushtetuese e ligjore janë në funksion të mbrojtjes sa më efektive të të pandehurit, pasi përballë tij qëndron vetë shteti, i përfaqësuar në procesin penal nga prokurori që paraqet dhe mbron akuzën kundër tij. Është detyrë e shtetit që të marrë masat e duhura për të garantuar pjesëmarrjen në procesin penal të personit të akuzuar ose mbrojtësit ligjor, qoftë edhe atij të caktuar kryesisht (*shih vendimin nr. 35, datë 1.6.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Lidhur me të drejtën e mbrojtjes, Gjykata është shprehur se ajo duhet të jetë reale dhe efektive e jo vetëm teorike dhe se ushtrimi i saj nuk duhet të pengohet, por, përkundrazi, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm duhet të marrin të gjitha masat ligjore që në funksion të procesit të rregullt ligjor t’i japin mundësinë individit të bëjë mbrojtje reale, duke respektuar parimin e barazisë së armëve (*shih vendimin nr. 35, datë 1.6.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Nga ana tjetër, Gjykata ka vlerësuar se situata juridike kur rekursi paraqitet nga i akuzuari, nuk është e njëjlojtë me rastin kur rekursi paraqitet nga prokurori. Në rastet kur rekursi paraqitet nga i akuzuari, Gjykata e Lartë nuk ka ndonjë pengesë për të vazhduar shqyrtimin e çështjes edhe në mungesë të avokatit të palës së akuzuar, për shkak se argumentet ligjore ai i ka depozituar me shkrim në rekursin e paraqitur përpara saj dhe pozita e tij nuk mund të rëndohet. Ndryshe paraqitet situata kur, si rrjedhojë e një rekursi të paraqitur nga prokurori, që mbart në vetvete mundësinë e përkeqësimit të pozitës së të pandehurit, gjykimi zhvillohet pa praninë e të gjykuarit ose të avokatit të tij. Në këtë rast, nëse as avokati, as i pandehuri nuk paraqiten në seancën e Gjykatës së Lartë, është e palejueshme që ajo të vazhdojë. Prezumimi se i pandehuri nuk ka marrë pjesë në gjykim me vetëdije, mund të justifikohet vetëm nëse atij i është bërë njoftimi personalisht dhe mund të vërtetohet që ai e ka marrë vetë atë. Në aspektin e garantimit të procesit të rregullt ligjor, për Gjykatën e Lartë del e domosdoshme marrja e masave në mënyrë që të mos lejojë zhvillimin e



seancës në mungesë të përfaqësuesit të interesave të të pandehurit, pasi kjo është e vetmja mënyrë që i pandehuri, përmes figurës përfaqësuese të avokatit, të marrë pjesë në debatet e mundshme (*shih vendimet nr. 6, datë 26.2.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Për sa i përket mënyrës së njoftimit të datës së seancës për gjykimin në Gjykatën e Lartë, sipas nenit 436/3 të KPP-së, sekretaria e Gjykatës së Lartë e afishon atë të paktën 10 ditë para datës së seancës.

14. Në rastin në shqyrtim, Gjykata vëren se seanca e parë gjyqësore në Gjykatën e Lartë është zhvilluar në datën 18.11.2015. Nga *website* i Gjykatës së Lartë, Gjykata konstaton se në listën e çështjeve penale për gjykim në këtë datë, nuk rezulton emri i kërkueses. Nga ana tjetër, kjo listë është shpallur në 11.11.2015, duke mos respektuar afatin 10-ditor i përcaktuar nga neni 436/3 i KPP-së. Në këtë seancë nuk kanë qenë të pranishëm as kërkuesja, as mbrojtësi i zgjedhur prej saj. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë i ka caktuar kërkueses mbrojtës kryesisht dhe e ka shtyrë seancën për në datën 2.12.2015. Edhe kjo seancë është shtyrë për shkak të mungesës së justifikuar të mbrojtësit të caktuar kryesisht. Lista e seancës së radhës, e datës 9.12.2015, është shpallur në datën 2.12.2015, përsëri duke mos u respektuar afati 10-ditor. Në këtë seancë kërkuesja është mbrojtur nga avokat i caktuar kryesisht, i cili ka depozituar edhe memorie.

15. Nga sa më lart, Gjykata vlerëson se edhe pse kërkueses i është caktuar mbrojtës kryesisht, Gjykata e Lartë jo vetëm nuk e ka njoftuar kërkuesen për datën e seancës, duke mos respektuar dispozitën për shpalljen e listës së gjykimit dhe të afateve përkatëse, por në mungesë të paraqitjes së mbrojtësit të caktuar prej saj në gjykim, nuk i ka marrë të gjitha masat për t'i dhënë kërkueses mundësinë për të pasur një mbrojtje reale dhe efektive. Për pasojë, Gjykata çmon se ky pretendim i kërkueses është i bazuar.

C. Për pretendimin për cenimin e parimit të paanshmërisë

16. Kërkuesja pretendon se Gjykata e Lartë ka cenuar parimin e paanshmërisë, pasi ka bërë një vlerësim të gabuar të rrethanave të çështjes dhe provave si dhe ka shqyrtuar çështjen në momentin kur publikisht ishte i njohur diskutimi

në Kuvendin e Shqipërisë i ligjit “Për dhënie amnistie”, sipas të cilit amnistoheshin të gjitha dënimet alternative të dhëna me vendim të formës së prerë para datës 30.11.2015, sikurse ishte rasti konkret.

17. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, ka prapësuar se kërkuesja nuk e ka ngritur në nivel kushtetues pretendimin për njëanshmëri të Gjykatës së Lartë. Fakti se kjo e fundit ka vendosur moszbatimin e nenit 59 të KP-së, duke hequr pezullimin e ekzekutimit të dënimit, nuk përbën bazë të mjaftueshme për të arritur në përfundimin se është shkelur ky parim.

18. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se gjykimi nga një gjykatë e paanshme është një nga elementet e rëndësishme të procesit të rregullt ligjor, i garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së. Parimi i paanshmërisë nënkupton mungesën e paragjytimeve nga gjyqtarët për çështjen e shtruar përpara tyre. Respektimi i këtij parimi duhet të verifikohet duke zbatuar dy teste, testin subjektiv, i cili në thelb kërkon të provuarit e faktit se bindja personale e një gjyqtari ka ndikuar në vendimin e gjykatës dhe, gjithashtu, testin objektiv, i cili kërkon të provuarit nëse gjyqtari ka ofruar garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të arsyeshëm në këtë drejtim. Në kuptim të testit subjektiv, paanshmëria e gjyqtarëve duhet të prezumohet derisa të provohet e kundërta. Për sa i përket testit objektiv, ai nënkupton se veç sjelljes personale të çdo anëtari të trupit gjykues, duhet të provohet nëse ka fakte bindëse, të cilat vënë në dyshim paanshmërinë. Në këtë kuadër edhe dukja e jashtme ka rëndësi. Për rrjedhojë, kur vlerësohet nëse në një çështje konkrete ka një arsye të përligjur që rrezikon paanshmërinë e një trupi gjykues, këndvështrimi i atyre që paraqesin këtë pretendim ka rëndësi, por vendimtar mbetet përcaktimi nëse ky dyshim është objektivisht i justifikueshëm (*shih vendimin nr. 11, datë 3.3.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Jurisprudenca e Gjykatës ka evidentuar se parimi i paanshmërisë në gjykim, në këndvështrim të përbërjes së trupit gjykues, duhet të respektohet në çdo shkallë të gjykimit. Për Gjykatën është konsideruar gjykatë e njëanshme trupi gjykues që nuk jep garancitë e nevojshme për një gjykim të paanshëm në



këndvështrimin objektiv. Dyshimi i mundshëm për paanësinë e gjyqtarit mund të ngrihet në hipotezën se gjyqtari është shprehur në një procedim tjetër me një vlerësim që ka të bëjë me përmbajtjen e të njëjtit fakt, në lidhje me të njëjtin subjekt (*shih vendimin nr. 11, datë 3.3.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Nga ana tjetër, në jurisprudencën kushtetuese është theksuar në mënyrë të vazhdueshme se interpretimi i ligjit, zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor, kurse problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave. Gjykata ndërhyr në ato raste kur, përmes veprimeve të tyre, gjykatat e zakonshme cenojnë të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Në këto raste, Gjykata nuk bën rivlerësim të fakteve e të rrethanave, por një vlerësim të natyrës kushtetuese, të ndryshëm nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Detyra e Gjykatës nuk është zgjidhja e një mosmarrëveshjeje juridike për çështje fakti, por identifikimi i fakteve të natyrës kushtetuese, të cilat shërbejnë për realizimin e kompetencave të saj dhe përbëjnë elementin thelbësor në përcaktimin e autoritetit të një gjykimi kushtetues (*shih vendimin nr. 62, datë 23.9.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Bazuar në këto standarde, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuases se Gjykata e Lartë ka bërë një vlerësim të gabuar të rrethanave të çështjes dhe provave, si dhe ka shqyrtuar çështjen në momentin kur publikisht ishte i njohur diskutimi në Kuvend i ligjit “Për dhënie amnistie”, nuk lidhen me parimin e paanshmërisë së saj. Gjykata çmon se këto pretendime në thelb kanë të bëjnë me çmuarjen nga ana e gjykatës të provave, si dhe me bindjen e saj të brendshme në lidhje me deklarinimin ose jo faktore të kërkuases. Si e tillë, kjo çështje i takon sferës së kompetencës së gjykatave të zakonshme, të cilat bëjnë vlerësimin juridik të rrethanave dhe

provave të parashtruara nga palët, dhe jo juridiksionit kushtetues. Ky i fundit nuk mund të zëvendësojë prerogativat kushtetuese e ligjore të vetë hallkave të sistemit gjyqësor, aq më tepër të vlerësojë bindjen e brendshme të gjykatave për çështje konkrete. Qëndrimi i mbajtur në jurisprudencën e kësaj Gjykate është se interpretimi i ligjit, zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave nuk hyjnë në juridiksionin kushtetues, përderisa pretendimet e kërkuarit nuk lidhen me cenimin e ndonjë standardi kushtetues.

22. Nga sa më lart, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuases për cenimin e parimit të paanshmërisë është haptazi i papabuar.

Ç. Për pretendimin për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit

23. Sipas kërkuases, Gjykata e Lartë ka cenuar standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, sepse nuk ka arsyetuar lidhur me moszbatimin e dënimit alternativ të parashikuar nga neni 59 i KP-së. Lidhur me këtë pretendim, subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, ka prapësuar se vendimi i kundërshtuar nuk rezulton të jetë alogjik, të ketë kundërthënie, si dhe ka respektuar të gjitha elementet e përcaktuara nga jurisprudenca kushtetuese lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor.

24. Gjykata ka theksuar tashmë se e drejta për një proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142/1 të Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Përveç kësaj, duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet edhe vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë (*shih vendimet nr. 18, datë 15.3.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka vlerësuar domosdoshmërinë e arsyetimit të vendimeve gjyqësore, penale apo civile, si një garanci për procesin ligjor. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i



një vendimi të drejtë. Vendimi mund të kontrollohet nga një gjykatë më e lartë sipas procedurave përkatëse dhe që kjo të jetë e mundur, duhet bërë arsyetimi i vendimit, në të cilin gjyqtari tregon me qartësi faktet dhe ligjin e zbatueshëm, të cilat e kanë çuar në bërjen e një zgjedhjeje ndërmjet disa mundësive. Vendimet gjyqësore që japin gjykatat e të gjitha niveleve në përfundim të gjykimit përbëjnë aktin procedural kryesor të të gjithë procesit gjyqësor. Ato përmbledhin dhe finalizojnë përfundimisht qëndrimet që mban gjykata lidhur me çështjen në gjykim (*shih vendimin nr. 18, datë 15.3.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Gjithsesi, Gjykata e ka vlerësuar zbatimin e këtij parimi rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre. Ajo ka verifikuar nëse vendimi i kundërshtuar është logjik, ka kundërthënë, përmban referenca në ligjin e zbatueshëm dhe nëse respekton të gjitha elementet e sipërpërmendura. Detyrimi i gjykatave për të respektuar këtë standard ndryshon në varësi të rrethanave të çështjes konkrete dhe natyrës së vendimit, dhe masa e arsyetimit varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimin nr. 18, datë 15.3.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Në rastin në shqyrtim Gjykata vlerëson se Gjykata e Lartë në vendimin e saj ka analizuar kërkesat e palëve dhe ligjin e zbatueshëm, duke përmbushur elementet e përcaktuara nga jurisprudenca e kësaj Gjykate për respektimin e standardit të arsyetimit të vendimit. I vetmi shkak i paraqitur nga kërkuësja është ai lidhur me zbatimin ose jo të nenit 59 të KP-së dhe gjithë arsyetimi i Gjykatës së Lartë (shih faqet 8-11 të vendimit të Gjykatës së Lartë) lidhet me këtë shkak. Në këtë kontekst, Gjykata ka theksuar se ajo e vlerëson arsyetimin e një vendimi gjyqësor vetëm në kuadër të përmbushjes ose jo të standardeve të mësipërme, pasi nuk është detyrë e saj të analizojë provat dhe faktet ku është bazuar gjykata për zgjidhjen e çështjes së themelit, sikurse pretendon edhe kërkuësi në rastin konkret. Kjo mbetet detyrë funksionale e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Në aspektin e kontrollit kushtetues, Gjykata verifikon nëse arsyetimi i vendimit gjyqësor i ka plotësuar ose jo kriteret e përcaktuara më sipër,

të cilat garantojnë të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar (*shih vendimin nr. 55, datë 18.12.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Për pasojë, Gjykata çmon se edhe ky pretendim i kërkuësës është i pabazuar.

28. Si përfundim, Gjykata çmon se në rastin konkret Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë i ka cenuar kërkuësës të drejtën për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur në gjykim, si element i së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Për rrjedhojë, ky pretendim i kërkuësës është i bazuar dhe duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.
 - Shfuqizimin si të papajtuësishëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr. 00-2015-3057, datë 9.12.2015, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
 - Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha, Besnik Imeraj, Gani Dizdari, Vladimir Kristo, Fatos Lulo

Anëtarë kundër: Altina Xhoxhaj, Fatmir Hoxha

MENDIM PAKICE

1. Në çështjen me kërkuëse Fatjona Koçibelli jemi kundër qëndrimit të shumicës për pranimin e kërkesës, shfuqizimin si të papajtuësishëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr. 00-2015-3057, datë 9.12.2015, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në po atë gjykatë.



2. Kërkuesja ka pretenduar se i është cenuar e drejta për t'u dëgjuar në Gjykatën e Lartë për arsye se ajo dhe mbrojtësi i saj nuk janë njoftuar për seancën gjyqësore. Sipas kërkueses, Gjykata e Lartë e ka shpallur datën e gjykimit të çështjes vetëm disa ditë përpara seancës gjyqësore, duke mos i dhënë mundësi asaj dhe mbrojtësit që të marrin dijeni për seancën, si dhe duke i caktuar një mbrojtës kryesisht, i cili nuk ka pasur mundësi të njihet me çështjen duke mos realizuar një mbrojtje efektive.

3. Në lidhje me standardet e së drejtës për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur në gjykim, Gjykata ka theksuar se e drejta e mbrojtjes duhet të jetë reale dhe efektive e jo vetëm teorike dhe se ushtrimi i saj nuk duhet të pengohet, por, përkundrazi, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm duhet të marrin të gjitha masat ligjore që në funksion të procesit të rregullt ligjor t'i japin mundësinë individit të bëjë mbrojtje reale, duke respektuar parimin e barazisë së armëve. Veçanërisht në procesin penal, barazia e armëve, kontradiktoriteti dhe lidhur ngushtë me këto, mbrojtja e të pandehurit përbëjnë në vetvete elementet më të qenësishme e thelbësore të procesit të rregullt ligjor në kuptimin kushtetues. Prandaj për respektimin e këtyre parimeve, gjykata duhet të përmbushë me rigorozitet një sërë detyrimesh, mes të cilave rëndësi të veçantë paraqet, sipas rastit, edhe njoftimi i të pandehurit apo mbrojtësit të tij ligjor për akuzën, ankimin, rekursin, ditën dhe vendin e gjykimit të çështjes, etj. Synim kryesor është realizimi i një debati real ndërmjet akuzës dhe mbrojtjes, gjë që ndikon pozitivisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë në zbulimin e së vërtetës dhe dhënien e drejtësisë nga gjykata me objektivitet e paanësi. Këto kërkesa kushtetuese e ligjore janë në funksion të mbrojtjes sa më efektive të të pandehurit, pasi përballë tij qëndron vetë shteti, i përfaqësuar në procesin penal nga prokurori që paraqet dhe mbron akuzën kundër tij. Është detyrë e shtetit të marrë masat e duhura për të garantuar pjesëmarrjen në procesin penal të personit të akuzuar ose mbrojtësit ligjor, qoftë edhe atij të caktuar kryesisht (*shih vendimin nr. 6, datë 26.2.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

4. Në lidhje me gjykimin në Gjykatën e Lartë është vlerësuar se situata juridike kur rekursi paraqitet nga i akuzuari, nuk është e njëllajtë me

rastin kur rekursi paraqitet nga prokurori. Prania personale e të pandehurit në seancën gjyqësore për shqyrtimin e ankimit të paraqitur nga mbrojtësi i tij nuk është e domosdoshme, nëse objekt shqyrtimi janë trajtimet dhe përfundimet juridike të arritura nga gjykata më e ulët, vendimi i së cilës nuk mund të ndryshohet në disfavor të të pandehurit. Në këto raste, Gjykata e Lartë nuk ka ndonjë pengesë për të vazhduar shqyrtimin e çështjes edhe në mungesë të avokatit të palës së akuzuar, për shkak se argumentet ligjore ai i ka depozituar me shkrim në rekursin e paraqitur përpara saj. Ndryshe paraqitet situata kur si rrjedhojë e një rekursi të paraqitur nga prokurori, që mbart mundësinë e përkeqësimit të pozitës së të pandehurit, gjykimi zhvillohet pa praninë e të gjykuarit ose të avokatit të tij. Në rast se as avokati, as i pandehuri nuk paraqiten në seancë në Gjykatën e Lartë është e palejueshme që ajo të vazhdojë. Prezumimi se i pandehuri nuk ka marrë pjesë në gjykim me vetëdije mund të justifikohet vetëm nëse atij i është bërë njoftimi personalisht dhe mund të vërtetohet që ai e ka marrë vetë atë. Në aspektin e garantimit të procesit të rregullt ligjor, për Gjykatën e Lartë del e domosdoshme marrja e masave në mënyrë që të mos lejojë zhvillimin e seancës në mungesë të përfaqësuesit të interesave të të pandehurit, pasi kjo është e vetmja mënyrë që i pandehuri, përmes figurës përfaqësuese të avokatit, të marrë pjesë në debatet e mundshme (*shih vendimin nr. 6, datë 26.2.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

5. Gjykata ka theksuar, gjithashtu, se personi që ushtron ankim/rekurs është i interesuar të ndjekë fatin e ankimit të tij, por kjo nuk nënkupton se i takon vetëm atij përgjegjësia të ndjekë pafundësisht fatin e dosjes gjyqësore, e cila administrohet nga gjykata dhe jo nga kërkuesi. Po në këtë drejtim, Gjykata është shprehur se është detyrë e administratës gjyqësore të njoftojë ankuesin/rekursuesin kur dokumentacioni që shoqëron ankimin/rekursin është i paplotë. Ajo ka theksuar se e drejta e ankimit, ashtu si edhe ajo e aksesit në gjykatë nuk mund t'i cenohen kërkuesit për shkaqe që rrjedhin nga mangësitë ose gabimet në veprimtarinë e vetë organeve shtetërore (*shih vendimin nr. 32, datë 22.7.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

6. Në rastin në shqyrtim, sipas shumicës, gjen



zbatim neni 436/3 i KPP-së, sipas të cilit sekretaria e Gjykatës së Lartë e afishon datën e seancës për gjykim të paktën 10 ditë para zhvillimit të saj. Seanca e parë gjyqësore në Gjykatën e Lartë është zhvilluar në datën 18.11.2015 dhe nga *website* i Gjykatës së Lartë rezulton se në listën e çështjeve penale për gjykim në këtë datë nuk ndodhet emri i kërkukses. Nga ana tjetër, kjo listë është shpallur në datën 11.11.2015, duke mos u respektuar afati 10-ditor i përcaktuar nga neni 436/3 i KPP-së. Në këtë seancë nuk kanë qenë të pranishëm as kërkuksesja, as mbrojtësi i zgjedhur prej saj dhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë i ka caktuar kërkukses mbrojtës kryesisht, duke e shtyrë seancën për në datën 2.12.2015, por edhe kjo seancë është shtyrë për shkak të mungesës së justifikuar të mbrojtësit të caktuar kryesisht. Lista e seancës së radhës, e datës 9.12.2015, është shpallur në datën 2.12.2015, përsëri duke mos u respektuar afati 10-ditor. Në këtë seancë kërkuksesja është mbrojtur nga avokat i caktuar kryesisht, i cili ka depozituar edhe memorie (*shih paragrafin 14 të vendimit*). Nisur nga këto rrethana shumica ka vlerësuar se edhe pse kërkukses i është caktuar mbrojtës kryesisht, Gjykata e Lartë jo vetëm nuk e ka njoftuar kërkuksen për datën e seancës, duke mos respektuar dispozitën për shpalljen e listës së gjykimit dhe të afateve përkatëse, por në mungesë të paraqitjes së mbrojtësit të caktuar prej saj në gjykim, nuk i ka marrë të gjitha masat për t'i dhënë kërkukses mundësinë për të pasur një mbrojtje reale dhe efektive (*shih paragrafin 15 të vendimit*).

7. Ne gjyqtarët në pakicë, në ndryshim nga përfundimi i arritur nga shumica, vlerësojmë se pavarësisht se për seancën e parë gjyqësore nuk është bërë shpallja në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, nuk është arritur të provohet se nuk është përmbushur detyrimi për afishimin e datës së seancës në këndin përkatës të njoftimeve në atë gjykatë, edhe pse i takonte kërkukses barra e provës për të provuar këtë pretendim të saj. Megjithatë, pavarësisht këtij fakti, Kolegji Penal, pasi ka konstatuar mungesën e kërkukses dhe të mbrojtësit të saj, ka vendosur t'i caktojë asaj mbrojtës kryesisht dhe e ka shtyrë seancën për në datën 2.12.2015, e cila është shtyrë më pas për në datën 9.12.2015 për shkak të mungesës së mbrojtësit të caktuar kryesisht. Për këto seanca

gjyqësore Gjykata e Lartë ka proceduar edhe me shpalljen publike, fakt që pranohet nga shumica në vendimin e saj.

8. Gjykata ka vlerësuar se jo çdo shkelje e rregullave procedurale e bën procesin të parregullt në aspektin kushtetues dhe se ndikim të drejtpërdrejtë në një proces ligjor kanë ato shkelje thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të individit. Duke shkuar më tej, Gjykata nuk ka pranuar pretendimet për cenimin e parimeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor në rastet kur gjykata e shkallës më të lartë ka plotësuar apo korrigjuar mangësitë e gjykatave të shkallëve më të ulëta në plotësimin e standardeve dhe elementeve të një procesi të rregullt ligjor (*shih vendimin nr. 9, datë 26.2.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Bazuar në faktet e çështjes konkrete dhe standardet e mësipërme, ne gjyqtarët në pakicë vlerësojmë se Gjykata e Lartë ka respektuar dispozitat procedurale për njoftimin e palëve dhe nuk ka cenuar të drejtën e kërkukses për një proces të rregullt ligjor. Ajo ka marrë masat për njoftimin e palëve dhe i ka garantuar kërkukses të drejtën e mbrojtjes nëpërmjet mbrojtësit të caktuar kryesisht, i cili ka marrë pjesë në gjykim, ku i është dhënë mundësia që të dëgjohet dhe të paraqesë argumentet e tij në kundërshtim të pretendimeve të palës tjetër në proces.

10. Në lidhje me argumentin e shumicës se Gjykata e Lartë nuk ka respektuar kërkesat e nenit 436/3 të KPP-së në lidhje me seancën e datës 9.12.2015, pasi shpallja është bërë në datën 2.12.2015, duke mos u respektuar afati 10-ditor, vlerësojmë se shumica mban një qëndrim të gabuar në lidhje me mënyrën e interpretimit të kësaj dispozite. Në interpretim të pikës 3 të nenit 436 të KPP-së rezulton se afati ligjor 10-ditor lidhet me njoftimin e palëve për seancën e parë gjyqësore që do të zhvillohet në Gjykatën e Lartë, por nuk nënkupton që ky afat zbatohet për të gjitha seancat e mëpasshme, kalendari i të cilave përcaktohet në varësi të volumit të çështjeve për shqyrtim në Kolegji. Gjithsesi, në vlerësimin tonë, mosrespektimi i këtij afati ligjor nuk mund të konsiderohet si shkelje kushtetuese, për sa kohë që Gjykata e Lartë gjatë shqyrtimit të çështjes u njeh palëve dhe u garanton të drejtat e tyre kushtetuese. Ajo çfarë vihet re gjithashtu në



rastin në fjalë është se vendimi i Gjykatës së Lartë nuk ka rënduar pozitën e kërkuases, për sa kohë që ka lënë në fuqi vendimet gjyqësore të gjykatave të faktit, me ndryshimin e moszbatimit të nenit 59 të KP-së, duke hequr pezullimin e ekzekutimit të vendimit.

11. Për sa më sipër, ne gjyqtarët në pakicë vlerësojmë se edhe pretendimi i kërkuases për cenimin e së drejtës për t'u mbrojtur dhe për t'u dëgjuar në Gjykatën e Lartë është i pabazuar, për rrjedhojë Gjykata duhej të vendoste rrëzimin e kërkesës.

Anëtarë: Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj

VENDIM

Nr. 126, datë 23.11.2016

PËR MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË RREGULLOREN “PËR FUNKSIONIMIN E SISTEMIT QENDROR TË REGJISTRIMIT DHE SHLYERJES SË TITUJVE (AFISAR)”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; me propozimin e Departamentit të Operacioneve Monetare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Për funksionimin e sistemit qendror të regjistrimit dhe shlyerjes së titujve (AFISaR)”, miratuar me vendimin nr. 76, datë 18.12.2014, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në nenin 26 pas pikës 2, shtohet pika 3 me përmbajtjen e mëposhtme:

“Për llogaritë e titujve të pjesëmarrësve të tërthortë nëpërmjet Bankës së Shqipërisë, të cilat janë të bllokuara në bazë të urdhrave/vendimeve nga autoritetet përkatëse, Banka e Shqipërisë mund të hapë llogari cash-i speciale për kalimin e vlerës së maturimit të titujve që gjenden në llogaritë e bllokuara.”.

b) Në nenin 50, pika 3, ndryshon sipas përmbajtjes së mëposhtme:

“3. Përjashtohen nga komisionet Ministria e Financave dhe personat fizikë me llogari titulli në Bankën e Shqipërisë. Personat juridikë me llogari titulli në Bankën e Shqipërisë përjashtohen vetëm nga komisionet e përcaktuara në pikën 5 të këtij neni. Përjashtime të tjera bëhen me vendim të Këshillit Mbikëqyrës.”.

c) Në nenin 50, pas pikës 5, shtohet pika 5/1 sipas përmbajtjes së mëposhtme:

“5/1 Komisionet për operacionet e veçanta, shlyhen në bazë ditore, në ditën e nesërme të punës. Administratori mund t'i dërgojë pjesëmarrësve në ditën e parë të punës të muajit kalendarik, një faturë përmbledhëse për komisionet e paguara në muajin paraardhës.

d) Në nenin 50, pika 6 ndryshon sipas përmbajtjes së mëposhtme:

“Komisionet aplikohen për të dyja palët në transaksione, përveç rasteve kur njëra palë është e përjashtuar nga komisionet sipas pikës 3 ose është Banka e Shqipërisë.”.

e) Neni 76, pika 2, shfuqizohet.

f) Përmbajtja e shtojcës 8 të rregullore ndryshon sipas përmbajtjes së shtojcës 8 bashkëngjitur këtij vendimi.

g) Shtojcat 13, 14, 17 dhe 18, shfuqizohen.

h) Në rregullore shtohet shtojca 19, sipas përmbajtjes së shtojcës 19 bashkëngjitur këtij vendimi. Referimi në rregullore për shtojcat 13, 14, 17 dhe 18 zëvendësohet me shtojcën 19.

2. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Departamenti i Operacioneve Monetare, Departamenti i Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës dhe Departamenti i Teknologjisë së Informacionit në Bankën e Shqipërisë, si dhe pjesëmarrësit e sistemit AFISaR.

3. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditë pas publikimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI
Gent Sejko


Shtojca 8 - Komisionet e aplikuara në sistemin AFISaR


Lloji i komisioneve	Në vlerë (lek)	Në përq indje
A. Komision për anëtarësim dhe mirëmbajtje		
Komision hyrjeje (anëtarësimi) për pjesëmarrësit e drejtpërdrejtë	250,000	
Komision hyrjeje (anëtarësimi) për pjesëmarrësit e tërthortë	0 (zero)	
Komision vjetor mirëmbajtjeje për pjesëmarrësit e tërthortë (persona juridikë) me llogari titulli në Bankën e Shqipërisë	250,000	
Komision vjetor mirëmbajtjeje për pjesëmarrësit e drejtpërdrejtë	250,000	
Komision vjetor mirëmbajtjeje për pjesëmarrësit e tërthortë me llogari titulli në pjesëmarrësit e drejtpërdrejtë përveç Bankës së Shqipërisë*	150,000	
Komision daljeje	0 (zero)	
B. Komision për operacionet e veçanta		
Komision (1) procesimi për operacionet DVP (shitje/blerjet, kredi brenda ditës me Bankën e Shqipërisë dhe transaksioni i kthimit, marrëveshje riblerjeje/ të anasjellta riblerjeje me Bankën e Shqipërisë dhe transaksioni i anasjelltë)	350	
Komision (2) procesimi për operacionet DVP (marrëveshje riblerjeje/ të anasjellta riblerjeje dhe transaksioni i anasjelltë të ndryshme nga ato me Bankën e Shqipërisë)	200	
Komision procesimi për operacionet FOP (transfertat e porto folit, transaksionet midis llogarisë vetjake të pjesëmarrësit të drejtpërdrejtë dhe llogarisë së një pjesëmarrësit të tërthortë që është klient i të njëjtit pjesëmarrës së drejtpërdrejtë, transaksionet midis dy pjesëmarrësve që kanë të njëjtin agjent shlyerës në AIPS, ekzekutimi i kolateralit, zëvendësimi i titullit në një marrëveshje riblerjeje, transaksionet për të plotësuar kërkesën për marzhin e ruajtjes së vlerës së titullit të tregtuar nëpërmjet marrëveshjeve të riblerjes)	350	
Komision për procesimin e rezultateve të tregut primar (emetim, maturim, ankand rihapjeje, ankand për blerjen mbrapsht të titullit)	200	
Komision për operacionet e netimit sipas modelit DVP2 për transaksionet e tregut primar	150	
Komision për procesimin e pagesës së interesave të përfituara nga investimi në titujt	1200	
Komision për procesimin e marrëveshjeve të kolateralit financiar (regjistrimi i kolateralit, lirimi i kolateralit)	350	



Komision për kthimin e kuponave nga rishitësi tek riblerësi në një marrëveshje repo/reverse repo	350	
Komision për riciklimin e transaksioneve të tregut primar	0 (zero)	
Komision për procesimin e operacioneve që rrjedhin nga thirja e titujve, nga ankandet e marrëveshjeve të riblerjes/ të anasjellta riblerjeje të Ministrisë së Financave, nga taksimi i titujve	0 (zero)	
C. Komisione të tjera		
Përgatitja e raporteve sipas kërkesës specifike	Për t'u vlerësuar në bazë të kërkesës specifike	
Komisione për trajnimin e operatorëve të sistemit	0 (zero)	
Komision për certifikimin e operatorëve të sistemit	0 (zero)	
Komision për pajisjen e aksesit në sistemit AFISaR	3 (tre) për pjesëmarrës falas, të tjerat me pagesë sipas kostos së pajisjes	
D. Zbritjet për të inkurajuar procesimin		
Për vëllimin e procesuar	0 (zero)	
Për kohën e procesimit	0 (zero)	

* Ky komision faturohet dhe mbledhet nga pjesëmarrësi i drejtpërdrejtë dhe më pas i transferohet Bankës së Shqipërisë.

SHTOJCA 19
FORMULARI I KËRKESËS PËR PËRDORUES

BANKA E SHQIPËRISË
SISTEMI AFISAR

FORMULARI I KËRKESËS PËR PËRDORUES NË VPN, PAJISJE SIGURIE, CERTIFIKATË DIXHITALE DHE PËRDORUES TË LIDHURA ME SISTEMIN AFISAR			
Të plotësohet ky formular për të administruar kredencialet e një përdoruesi në rrjetin VPN, në pajisjen e sigurisë dhe certifikatën dixhitale në FTP, si dhe në sistemin AFISaR			
Për:	Banka e Shqipërisë Departamenti i Operacioneve Monetare		
Nga institucioni emetues _____		Data e kërkesës: __/__/____ (dd/mm/vvvv)	
1. Kërkesë për ndryshime në rrjetin VPN			
Nr.	Emri/mbiemri i përdoruesit	Veprimi	
1		Krijim përdoruesi të ri	<input type="checkbox"/>
		Reset fjalëkalimin e përdoruesit	<input type="checkbox"/>
		Fshirje përdoruesi ekzistues	<input type="checkbox"/>
2. Kërkesë për pajisje të re sigurie			
Nr.	Emri/mbiemri i përdoruesit	Lloji i pajisjes	Copë
1			



3. Kërkesë për certifikatë dixhitale

Nr.	Emri/mbiemri i përdoruesit	Veprimi	
1		Gjenerim certifikateje të re	<input type="checkbox"/>
		Rigjenerim certifikateje	<input type="checkbox"/>
		Zhblokim dhe reset fjalëkalimi i pajisjes së sigurisë	<input type="checkbox"/>
		Revokim certifikateje	<input type="checkbox"/>

4. Kërkesë për ndryshime në FTP

Nr.	Emri/mbiemri i përdoruesit	Veprimi	
1		Krijim përdoruesi të ri	<input type="checkbox"/>
		Reset fjalëkalimi të përdoruesit	<input type="checkbox"/>
		Fshirje përdoruesi ekzistues	<input type="checkbox"/>

5. Veprime në llogarinë e përdoruesit në sistemin AFISaR

(Të plotësohet vetëm në rast të pamundësisë së kryerjes së veprimit nga Oficerët e Sigurisë së Pjesëmarrësit)

Nr.	Emri/mbiemri i përdoruesit	Veprimi		Emërtimi i profilit të përdoruesit
1		Krijim përdoruesi	<input type="checkbox"/>	
		Aprovim i krijimit të përdoruesit	<input type="checkbox"/>	
		Rivendosje fjalëkalimi	<input type="checkbox"/>	
		Aprovim i rivendosjes së fjalëkalimit	<input type="checkbox"/>	
		Aktivizim llogarie	<input type="checkbox"/>	
		Aprovim i aktivizimit të llogarisë	<input type="checkbox"/>	
		Çaktivizim llogarie	<input type="checkbox"/>	
		Aprovim i çaktivizimit të llogarisë	<input type="checkbox"/>	
		Modifikim i profilit të përdoruesit	<input type="checkbox"/>	
		Aprovim i modifikimit të profilit të përdoruesit	<input type="checkbox"/>	
		Mbyllje llogarie	<input type="checkbox"/>	
		Aprovim i mbylljes së llogarisë	<input type="checkbox"/>	

Arsyeja për veprimin e kërkuar (e detyrueshme për t'u plotësuar):

Komente: _____

Për institucionin emetues

Autorizuesi i kërkesës

(_____)

Për Bankën e Shqipërisë

Autorizuesi i kërkesës

(_____)

**NJOFIM****I MINISTRISË SË PUNËVE TË JASHTME**
Nr. 14148, datë 24.11.2016**MBI HYRJEN NË FUQI TË**
MARRËVESHJEVE NDËRKOMBËTARE

1. Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Indonezisë për heqjen e vizave për mbajtësit e pasaportave diplomatike dhe të shërbimit, nënshkruar më 26.9.2015, hyrë në fuqi më 11.11.2016.

2. Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Urdhrit Sovran Ushtarak Bamirës të Shën Gjonit të Jerusalemit, të Rodit dhe Maltës, nënshkruar më 15.6.2016, hyrë në fuqi më 5.10.2016.

3. Marrëveshje midis Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë mbi bashkëpunimin financiar 2014 për masat shoqëruese të projektit “Linja Unazore 110 kV në Shqipërinë Jugore, përmirësimi i eficiencës në fushën e energjisë”, nënshkruar më 9.12.2015, hyrë në fuqi më 3.8.2016.

4. Marrëveshje midis Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë mbi bashkëpunimin financiar 2015 për projektin “Program për rinovimin e konvikteve në Kampusin Universitar të Tiranës, sipas parimit të eficiencës energjetike”, nënshkruar më 21.4.2016, hyrë në fuqi më 3.8.2016.

5. Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Fondit Global kundër Sida-s, Tuberkulozit dhe Malaries, nënshkruar më 17.6.2016, hyrë në fuqi më 2.9.2016.

6. Marrëveshje mbi ofrimin e ndërsjellë të truallit dhe ambienteve të ambasadave ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Popullore të Kinës, nënshkruar më 25.8.2016, hyrë në fuqi në datën e nënshkrimit (vlefshmëria 70 vjet/shfuqizon Marrëveshjen reciproke mbi Ambasadën në mes të Ambasadës së Republikës Popullore të Kinës në Shqipëri dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë, më 1 prill 1960).

7. Konventa e Këshillit të Evropës mbi falsifikimin e produkteve mjekësore dhe krime të ngjashme të cilat përbëjnë kërcënim për shëndetin publik, bërë në Moskë, më 28.10.2011, nënshkruar nga Shqipëria më 17.12.2015, hyrë në fuqi më 1.10.2016.

8. Marrëveshja e Parisit në Kuadër të Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi ndryshimet klimatike, bërë në Paris, më 12.12.2015, nënshkruar nga Shqipëria më 22.4.2016, hyrë në fuqi më 4.11.2016.

9. Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë të përfaqësuar nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës dhe Qeverisë së Republikës Italiane të përfaqësuar nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar për realizimin e “Programit për përgatitjen e studimeve të fizibilitetit dhe projektimit në nivel përfundimtar si dhe studimin e impaktit mjedisor në sektorin e infrastrukturave”, nënshkruar në Tiranë, më 12.4.2016, hyrë në fuqi më 13.10.2016.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM
Gazmend Barbullushi

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2016

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 168 lekë